

FONDI I PENSIONIT VULLNETAR ALBSIG

PASQYRAT FINANCIARE

30 shtator 2020

(të paaudituar)

TABELA E PERMBAJTJES

1. Pasqyra e asetëve të fondit të pensionit
2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit
3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto
4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit
5. Pasqyra e strukturës së investimeve me të gjitha pasqyrat përbërëse të saj
 - 5.1 Pasqyra e strukturës së investimeve , Obligacionet
 - 5.2 Pasqyra e strukturës së investimeve të fondit, Depozitat me afat
 - 5.3 Pasqyra e strukturës së investimeve të fondit, Investime të tjera
6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit
7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara të fondit
8. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të porealizuara të fondit
9. Tabela e planeve të pensionit
10. Tabela e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit
11. Tabela e numrit të anëtarëve të larguar nga fondi i pensionit
12. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit sipas grupmohave
13. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit
14. Shënimet e pasqyrave financiare

1. Pasqyra e aseteve të fondit të pensionit
Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.09.2020

Zërat e aktivitet	Lek	
	31.12.2019	30.09.2020
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	0,00	3.891.387,74
2. Investime (2.1+2.2+2.3)	0,00	28.874.698,58
2.1 Letra borxhi të blera në emetimin e parë (2.1.a+2.1.b+2.1.c)	0,00	13.776.061,70
2.1.a Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes	0,00	0,00
2.1.b Investime financiare të vlefshme për shitje	0,00	0,00
2.1.c Investime financiare të mbajtura deri në maturim	0,00	13.776.061,70
2.2 Letra borxhi të blera në treg sekondar (2.2.a+2.2.b+2.2.c)	0,00	15.098.636,87
2.2.a Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes	0,00	0,00
2.2.b Investime financiare të vlefshme për shitje	0,00	0,00
2.2.c Investime financiare të mbajtura deri në maturim	0,00	15.098.636,87
2.3 Depozita	0,00	0,00
3. Llogari të arkëtueshme	0,00	306.667,17
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë	0,00	0,00
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese	0,00	0,00
3c. Të arkëtueshme nga depozitari	0,00	0,00
3d. Parapagime	0,00	0,00
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë	0,00	0,00
3f. Të arkëtueshme të tjerë	0,00	306.667,17
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	0,00	33.072.753,48
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë	0,00	0,00
5. Detyrime nga investimi në depozita	0,00	0,00
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	0,00	65.026,61
7. Detyrime ndaj depozitarit	0,00	0,00
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	0,00	0,00
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë	0,00	0,00
10. Detyrime të tjera	0,00	0,00
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE	0,00	65.026,61
C (A-B) AKTIVET NETO TE FONDIT TE PENSIONIT	0,00	33.007.726,87
D Numri i kuotave të fondit të pensionit të emetuara	0,0000	32.662,6464
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT	0	1.010,57

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Nr.		Lek	
		01.07.2019 - 30.09.2019	01.07.2020 - 30.09.2020
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	0,00	0,00
2	Të ardhura nga interesat	0,00	315.872,50
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit	0,00	0,00
4	Të ardhura nga dividendët	0,00	0,00
5	Të ardhura nga interesat e depozitave	0,00	2.464,81
6	Të ardhura të tjera	0,00	51,96
A (1+2+3+4+5+6)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	0,00	318.389,28
	SHPENZIMET		
7	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë	0,00	0,00
8	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare	0,00	0,00
9	Tarifa për shoqërinë administruese	0,00	177.898,80
10	Tarifa për depozitarin	0,00	0,00
11	Shpenzime të tjera / provigjone	0,00	83,93
B (7+8+9+10+11)	TOTALI I SHPENZIMEVE	0,00	177.982,73
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	0,00	140.406,55
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e porealizuar nga investimet në letra me vlerë, +/-	0,00	0,00
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë	0,00	0,00
d3	Amortizimi I primit/diskauntit te aktiveve me afat maturimi fiks	0,00	-3.860,58
d4	Zhvleresimi I aktiveve	0,00	0,00
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-	0,00	-3.860,58
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETIVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	0,00	136.545,97
F	TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE		
	Zërat që mund të klasifikohen më pas në fitim ose humbje:		
	Letra të vlefshme për shitje:		

	Fitim/humbjet që lindin gjatë vitit nga letrat e vlefshme për shitje		
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Nr.		Lek	
		01.07.2019 - 30.09.2019	01.07.2020 - 30.09.2020
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1 (nga FPF 2 C)	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-		140.406,55
2 (nga FPF 2 D)	Totali i fitimeve (humbjeve) të përcaktuara nga investimet në letra me vlerë, +/-		-3.860,58
3	Rivlerësimi i aseteve financiare të vlefshme për shitje		
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I ASETEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		136.545,97
4	Kontribute nga anëtarët e fondit		9.429.528,97
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë		0,00
6	Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit		0,00
7	Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor		
8	Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të Pensionit		
B (4-5-6-7-8)	RRITJA (ZVOGËLIMI) TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E PENSIONIT, +/-		9.429.528,97
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-		9.566.074,94
D	AKTIVET NETO		
9	Në fillim të periudhës		23.441.651,93
10	Në fund të periudhës		33.007.726,87
	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		
11	Kuota të pensionit të emtuara mbi bazën e kontributeve		9.356,1328
12	Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (-)		0,00
13	Kuota për tërheqjet e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit / e parakohshme (-)		0,00
14	Kuota të tërheqjeve të pensioneve mujore (-)		0,00

15	Kuota të tërheqjeve të pensionit në mënyrë të menjëhershme (-)		0,00
E (11-12-13-14-15)	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		9.356,1328

4. Pasqyrat mbi kuotat e fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Nr.	Lloji	Numri i kuotave të fondit	Aktivet e fondit (Lek)	Aktive për kuotë (Lek)
1	Në fillim të periudhës	23.306,5136	23.441.651,9326	1.005,7983
2	Emetuar gjatë periudhës	9.356,1328	9.429.497,0000	1.007,8413
3	Tërhequr për shkak të ndryshimit të anëtarësisë	0,00	0,00	0,00
4	Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit (tërheqje e parakohshme)	0,00	0,00	0,00
5	Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor	0,00	0,00	0,00
6	Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të pensionit	0,00	0,00	0,00
7	Në fund të periudhës	32.662,6464	33.007.726,8717	1.010,5650

5. Pasqyra e strukturës së investimeve

5.1 Pasqyra e strukturës së investimeve – Obligacionet

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.09.2020

Lloji	Vlera nominale	Kostoja e prokuruar	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në pronën e emetuesit, %	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit, %
AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	900.000,00	920.182,76	929.898,12	0,02	2,81

AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	3.000.000,00	3.066.954,66	3.099.763,67	0,08	9,37
AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	3.300.000,00	3.380.945,09	3.417.704,81	0,08	10,33
AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	5.100.000,00	5.192.102,10	5.251.554,50	0,13	15,88
AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	3.800.000,00	3.774.015,69	3.821.042,87	0,10	11,55
AL021NF10Y30 / AL021NF10Y30	2.500.000,00	2.548.216,83	2.570.398,93	0,07	7,77
AL021NF10Y30 / AL021NF10Y30	10.000.000,00	10.000.000,00	10.090.706,72	0,29	30,51
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)	28.600.000,00	28.882.417,13	29.181.069,62	0,77	88,22
Të mbajtura deri në maturim (HTM)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare	28.600.000,00	28.882.417,13	29.181.069,62	0,77	88,22
Me qëllim tregtim (HFT)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Të vlefshme për shitje (AFS)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)	0	0	0	0	0
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE VENDAS	28.600.000,00	28.882.417,13	29.181.069,62	0,77	88,22
Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00

Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00

5.2 Pasqyra e strukturës së investimeve – Depozitat me afat

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.09.2020

Lloji	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit, %
Depozita afatshkurtër (> 3 muaj dhe <= 1 vit)		
Depozita afatgjatë (> 1 vit)		
D32	3.860.296,11	11,69
Depozita të tjera (<= 3 muaj)	3.860.296,11	11,69
TOTALI I DEPOZITAVE	3.860.296,11	11,69

5.3 Pasqyra e strukturës së investimeve – Investime të tjera

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.09.2020

Lloji	Vlera në datën e raportimit	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
BO	31.387,74	0,09
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare (brenda vendit)	31.387,74	0,09
Aktive të tjera (brenda vendit)	0	0
TOTALI BRENDA VENDIT	31.387,74	0,09
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare (jashtë vendit)	0,00	0,00
Asete të tjera (jashtë vendit)	0,00	0,00
TOTALI JASHTË VENDIT	0,00	0,00

6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Vlera totale e asetëve të fondit: LEK									
Struktura e asetëve	Total	Deri në 1 muaj	> 1 muaj deri 3 muaj	> 3 muaj deri 6 muaj	> 6 muaj deri 1 vit	> 1 vit deri 3 vjet	> 3 vjet deri 5 vjet	> 5 vjet deri 7 vjet	> 7 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentë	31.387,74	31387,74	0	0	0	0	0	0	0
	0,09%	0,09%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Depozita bankare	3860296,11	3860296,11	0	0	0	0	0	0	0
	11,67%	11,67%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Bono thesari RSH	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Obligacione qeveritare RSH	29181069,63	0	0	0	0	0	0	0	29.181.069,63
	88,23%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	88,23%
Obligacione qeveritare jashtë vendit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Obligacione të korporatave	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Asete të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%

Total Portofoli i Investimeve	33.072.753,48	3891683,85	0	0	0	0	0	0	29.181.069,63
	100,00%	11,77%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	88,23%
Kthyeshmëria	4,60%								
Modified Duration	6,49%								

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të porealizuara të fondit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Letra me vlerë të shitura	ISIN	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes	Vlera e tregut	Fitimi i porealizuar nga ndryshimi i cmimit	Ndryshimi neto në vlerën e investimit nga kursi i këmbimit	Amortizimi i primit/diskauntit të aktiveve me afat maturimi fiks	Zhvlerësimi i aktiveve
ALO20NF10Y30 / ALO20NF10Y30	ALO20NF10Y30	17.03.2020	3.380.945,09	3.377.941,64	0,00	0,00	-1.564,90	0,00
ALO20NF10Y30 / ALO20NF10Y30	ALO20NF10Y30	06.02.2020	920.182,76	919.053,62	0,00	0,00	-379,56	0,00
ALO20NF10Y30 / ALO20NF10Y30	ALO20NF10Y30	24.02.2020	3.066.954,66	3.063.615,34	0,00	0,00	-1.267,41	0,00
ALO20NF10Y30 / ALO20NF10Y30	ALO20NF10Y30	14.04.2020	3.774.015,69	3.775.254,98	0,00	0,00	606,80	0,00

AL020NF10Y30 / AL020NF10Y30	AL020NF10Y30	22.05.2020	5.192.102,10	5.190.102,33	0,00	0,00	-1.769,33	0,00
AL021NF10Y30 / AL021NF10Y30	AL021NF10Y30	28.07.2020	10.000.000,00	10.000.806,72	0,00	0,00	806,72	0,00
AL021NF10Y30 / AL021NF10Y30	AL021NF10Y30	24.08.2020	2.548.216,83	2.547.923,93	0,00	0,00	-292,90	0,00
Obligacione të Qeverisë			28.882.417,14	28.874.698,58	0,00	0,00	-3.860,58	0,00
HTM			28.882.417,14	28.874.698,58	0,00	0,00	-3.860,58	0,00
HFT								
AFS								
Bono të thesarit			0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Obligacione të shoqërive			0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Fonde të indeksuara			0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Letra me vlerë të tjera			0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Totali			28.882.417,14	28.874.698,58	0,00	0,00	-3.860,58	0,00

8. Tabela e planeve të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Planet e pensionit	Nr.
Numri i planeve individuale të pensionit	102
Numri i planeve profesionale të pensionit (kontrata punonjës-shoqëri administruese)	1675
Numri i planeve të pensionit të krijuara nga subektet (kontrata subjekte-shoqëri administruese)	19

9. Tabela e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Anëtarë sipas planeve të pensionit	Nr. I anëtarëve
Anëtarë në planet individuale	102
Anëtarë në planet profesionale	1662
Anëtarë gjithsej	1764

10. Tabela e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit sipas grupmoshave

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

Ndarja e anëtarëve sipas grupmoshave	Nr. i anëtarëve
< 25 vjeç	158
25 vjeç – 30 vjeç	244
30 vjeç – 40 vjeç	479
40 vjeç – 50 vjeç	393
50 vjeç – 60 vjeç	360
> 60 vjeç	130
Anëtarë pa moshë të identifikuar	0
Total	158

11. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.09.2020

Gjendja e kontributeve të klientëve deri më (30.09.2020) (në Lek)	Vlera në Lek
Nga anëtarë vullnetarë	2.679.943,40
Punonjës + Punëdhënës	30.112.492,00
Totali	32.792.435,40
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	17.860.151,00
Kontributet e punonjësve	12.252.341,00
Totali	30.112.492,00

Kontribute të derdhura nga 01.07.2020 – 30.09.2020 (në Lek)	Vlera në Lek
Nga anëtarë vullnetarë	805.000,00
Punonjës + Punëdhënës	8.624.497,00
Totali	9.429.497,00
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	5.027.828,00
Kontributet e punonjësve	3.596.669,00
Totali	8.624.497,00

12. Shënime të pasqyrave financiare të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Vullnetar i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 01.07.2020 - 30.09.2020

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” në 22 nëntor 2019, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”) bazuar në Vendimin nr. 210, miratoi “Fondi i Pensionit Vullnetar “Albsig” (Ref. FP4).

Shoqëria “Albsig Invest Sh.a.” – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive aktualisht administron vetëm një fond pensioni vullnetar të quajtur Fondi i Pensionit Vullnetar “Albsig”, i cili nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik.

Mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi gjithashtu Bankën Tirana Sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig.

Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig. Për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë administruese dhe Fondin paraqiten të ndara.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në këto pasqyra financiare.

a) Instrumentet financiare

Njohja dhe çrregjistrimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare njihen kur Fondi bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitetet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shlyhet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivitetet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitetet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar (AC)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëposhme e aktiveve financiare

(i) Aktivitet financiare me kosto të amortizuar

Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, si dhe obligacioneve të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

(ii) Aktivitet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivitet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivitet financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit klasifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të paracaktuara si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Kjo kategori gjithashtu përmban investimet në kapital. Aktivitet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

(iii) Aktivitet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Shoqëria llogarit aktivitet financiare më me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivitet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe

- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çrregjistrimit të aktivitetit.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlërësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlërësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlërësim për aktivet financiare me 30 shtator 2020.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Fondit nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Fondi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më

pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria nuk përdor kontabilitetin mbrojtës sipas SNRF 9.

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo ineficence në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

b) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshin gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

c) Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur në baza rritëse dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

d) Fitim (Humbjet) e realizuara

Fitim (humbjet) e realizuara krijohen në rastin e shitjes/maturimit të letrave me vlerë me çmim të ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlere dhe efektet transferohen në pasqyrën e të ardhurave/shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

e) Fitim (Humbjet) e porealizuara

Fitim (humbje) të porealizuara janë njohur si diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së drejtë të një letre me vlerë. Kur letra me vlerë shitet vlere e fitim (humbjeve) të porealizuara transferohet në fitim (humbje) të realizuara të periudhës.

f) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar.

g) Vlora neto e aktiveve të Fondit

Vlora neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

h) Vlora e kuotës së Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig

Vlora e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlora fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 1000 Lekë, në përputhje me politikën e Fondit.

i) Të ardhurat nga interesat e letrave me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose çregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesat e obligacioneve të thesarit të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Fondit.

j) Tarifa e administrimit

Fondi detyrohet t'i paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë prej 2,5 % (në bazë vjetore) të Vlerës Neto të Aktiveve, shpenzim ky për Fondin i cili përlllogaritet në bazë ditore.

4. Strategjia e investimeve të aseteve të Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig

Politika e Investimeve përbën dokumentin kryesor që kontrollon strategjinë e investimeve të Fondit. Së bashku me Politikën e Menaxhimit të Rrezikut përbëjnë dy shtyllat kryesore për të administruar dhe realizuar objektivat kryesore të fondit. Fondi do të menaxhohet në përputhje me të gjithë ligjet dhe rregulloret jo të limituara vetëm me Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit

Vullnetar”, si dhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese, miratuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë.

Elementët kryesorë të Politikës së Investimit janë:

- Përcaktimi i qartë i ndarjeve të përgjegjësive të Këshillit të Administrimit, Komitetit të Investimit, Pjesmarrësve të Fondit (anëtarët), dhe Depozitarit;
- Përcaktimi i Objektivave dhe i kufizimeve të investimit;
- Përcaktimi i alokimit të aseteve të fondit;
- Vlerësimi i performancës së fondit në krahasim me “*benchmark*”-un e përcaktuar;
- Vendosja e procedurës së komunikimit midis Këshillit të Administrimit, Depozitarit dhe Komitetit të Investimeve.

a) **Kuadri ligjor**

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Albsig Invest Sh.a i përmbahet ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe rregullores “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit”, miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr. 1, datë 28.01.2010, i ndryshuar.

b) **Investimet e lejuara**

Sipas rregullores, asetet e fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
- bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- depozita bankare në banka të licencuara
- letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);
- aksione ose kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

c) **Kufiri i Investimeve të lejuara**

Asetet e fondit nuk mund të investohen më shumë se:

- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s, ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 %, në një emetues të vetëm;

- 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:
 - që asetet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong); ose
 - që asetet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së;
- 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
 - jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm.
 - kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

d) Investimet e ndaluara

- obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës;
- asete, që nuk mund të shiten ose transferohen;
- instrumente derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit apo nga rreziqe të ngjashme;
- asete fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si, antika, punime arti, mjete motorike etj;
- aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
 - çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - depozitari i fondit të pensionit;
 - çdo person, palë e lidhur me aksionarin e shoqërisë administruese dhe me depozitarin e fondit të pensionit;
 - kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë shoqëria administruese;
 - letra borxhi, të emetuara nga vetë punëdhënësi.

e) Alokimi Strategjik i Aseteve

Pjesa më e madhe e alokimit të asetëve i përket letrave me vlerë të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim të përcaktimit të një tolerance minimale ndaj rrezikut dhe vlerësimit të kushteve të tregut të kapitalit alokimi strategjik pasqyrohet si më poshtë:

Klasa e asetëve	Minimumi	Maksimumi	Objektivi
Titujt shtetërorë afatgjatë të emtuar e garantuar nga Qeveria e Shqipërisë	70%	100%	99%
Cash dhe ekuivalente të saj	1%	15%	1%
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhën EUR	0%	30%	0%












Politika Fiskale dhe ajo Monetare ndikojnë ndjeshëm në normat e interesit të bonove të thesarit. Si të tilla ato do të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar impaktin e tyre në asetet e fondit.

Alokimi i aseteve do rishikohet nga të paktën një herë në vit. Rishikimi nënkupton vlerësimin e kushteve të tregut dhe jo domosdoshmërisht ndryshimin e alokimit të aseteve.

5. Administrimi i rrezikut financiar

f) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumenteve financiare e ekspozon Fondin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

-  Rreziku i tregut
-  Rreziku i Inflacionit
-  Rreziku i Kredisë
-  Rreziku i Likuiditetit
-  Rreziku Operacional
-  Rreziku i Përputhshmërisë
-  Rreziku i Reputacionit
-  Rreziku i Agjencisë
-  Rreziku i ndryshimit të tatimit mbi pensionin vullnetar
-  Rreziku Ligjor
-  Rreziku Politik

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Fondit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut.

Struktura e administrimit të rrezikut

Sipas ligjit nr.10197 datë 12 dhjetor 2009 “Mbi fondet vullnetare të pensioneve”, Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut.

Për të menaxhuar rrezikun e tregut financiar, Shoqëria ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sadoherë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara.

Rreziku i tregut

Nënkupton luhatjet e vlerave të aseteve financiare si pasojë e ndryshimeve të: a) normave të interesit, dhe b) të kurseve të këmbimit. Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së asetit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së asetit financiar. Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhatje të vlerës së asetit të konvertuar në monedhën vendase, lekë.

Shoqëria administruese duke përdorur strategjinë e investimit të aseteve sipas detyrimeve ul ndjeshëm ekspozimin e fondit ndaj rrezikut të normave të interesit duke i konsideruar si “detyrime implicite” vlerën e aseteve të klientëve dhe kohën e tyre të daljes në pension. Por nëse një anëtar do të dali nga fondi i pensionit përpara kohëzgjatjes së investimit (10-30 vjet) mund të paralizohet nga ky rrezik nëse normat e interesit do të jenë rritur.

Asetet në valutë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjes së pafavorshme të kurseve të këmbimit. Ekspozimi në valutë do jetë pothuajse 0 (zero) pasi shpërndarja strategjike është parashikuar të jetë 0% në këtë klasë aseti. Nëse anëtari do dali nga fondi pensionet përpara kohëzgjatjes së investimit (10-30 vjet) mund të penalizohet nga ky rrezik.

Rreziku i Inflacionit

Investimi për një kohë të gjatë siç është dhe investimi për pension shoqërohet me rrezikun e inflacionit, pasi rritja e përgjithshme e çmimeve nënvlerëson shumat e parave të marra në kohë shumë të largëta. Për të përlogaritur normën reale të kthimit anëtari duhet të zbres nga norma e tij e përfituar nga fondi normën e inflacionit. Gjithashtu norma e inflacionit mund të ketë ndikim tek normat afatgjatë e obligacioneve të Shtetit Shqiptarë duke i rritur ato dhe duke ulur vlerën e tyre.

Asete me të ardhura fikse siç janë obligacionet nuk janë mbrojtës shumë të mirë të inflacionit. Asetet të ashtuquajtura “reale” si aksionet, pasuritë e paluajtshme dhe mallrat janë mbrojtës më të mirë të inflacionit, por ato përmbajnë përgjithësisht më shumë rrezik se asetet me të ardhura fikse si obligacionet. Fondi i pensionit vullnetar Albsig është ndërtuar për klient konservator me tolerancë të ulët rreziku.

Shoqëria ka ndërtuar një aplikacion ku anëtarët do mund të monitorojnë një objektiv të tyre për pension, duke kontrolluar në këtë mënyrë nëse pensioni që do përfitojnë do jetë i mjaftueshëm apo jo.

Rreziku i kredisë

Nënkupton mospagimin nga emetuesi i asetit financiar të detyrimeve të tij në formë interesi periodik dhe/ose principali. Gjithashtu përkeqësimi i aftësisë paguese të një emetuesi reflektohet direkt tek çmimi i obligacionit duke e ulur atë dhe duke ulur për rrjedhojë vlerën neto të aseteve. Përkeqësimi i aftësisë paguese vjen zakonisht nga përkeqësimi i deficitit buxhetor.

Investimi në obligacione të Shtetit Shqiptarë është i lidhur me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptarë. Tradicionalisht rreziku i kredisë vlerësohet i ulët për obligacionet Qeveritare.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë. Instrumente të matura me kosto të amortizuar, pa vonesa dhe të pazhvlerësura.

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Obligacione të RSH ¹	28.874.698,58	-
VLERA KONTABËL	28.874.698,58	-

¹ Qeveria Shqiptare vlerësohet si B +, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Standard & Poor’s dhe B1 e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Moody’s.

Rreziku i likuiditetit

Përbën pamundësinë për të shitur asetet e fondit në rast kur shoqëria duhet të përmbush detyrimet e saj për tërheqje apo shitja e asetit me çmim të pafavorshëm. Investimi i fondit në asete jo-likuide mund të sjellë ulje të normës së kthimit kur aseti shitet vetëm me një çmim shumë të pafavorshëm.

Fondi duke konsideruar që “detyrimet” e tij janë shumë afatgjata të cilat lidhen me daljen e anëtarëve në pension dhe duke konsideruar faktin që do ketë çdo muaj hyrje nga skemat profesional dhe individuale, fondi nuk e ka të domosdoshme mbajtjen e aseteve me maturime të shkurtra apo të një shpërndarje të madh në llogari monetare për arsye likuiditeti që mund të vijnë nga tërheqjet. Shoqëria do mbaj si mjete monetare dhe depozita bankare një shpërndarje strategjike prej 1%.

Rreziku Operacional

Përbën humbjet e mundshme nga gabime apo keq funksionime të sistemeve të brendshme apo procedurave të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndërton sisteme kontrolli të brendshme dhe procedura duke parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda Shoqërisë Administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria për të administruar Fondin përdor një sistem operative i cili është ndërtuar duke respektuar parimin e 4 (katër) syve.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

Rreziku i Përputhshmërisë

Është mundësia e mos përmbushjes së akteve ligjore dhe rregulloreve që bien mbi të. Kompanitë e administrimit të fondeve të pensionit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive operojnë në një treg që është shumë i rregulluar. Ky rrezik mund të sjell efekte negative për shkak të mos zbatimit të rregulloreve kryesisht ato që rregullojnë nivelin e kapitalit dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Shoqëria administruese ka ndërtuar bazën e plotë rregullatore të brendshme për të shmangur rrezikun e përputhshmërisë. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet) nëse ai është në përputhje me rregulloret dhe prospektit.

Shoqëria administruese do të ndërtojë një sistem solid të vlerësimit periodik të aseteve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit. Në të njëjtën kohë do të informojë çdo anëtar të fondit në mënyrë elektronike për rregullat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rreziku i Reputacionit

Rreziku i reputacionit është një dëmtim i emrit të mirë të shoqërisë administruese apo grupit ku ajo bën pjesë. Ky rrezik mund të vij nga sjellja e shoqërisë administruese apo nga sjelljet e punonjësve të shoqërisë administruese.

Shoqëria Administruese ndjek parime të mirëqeverisjes të shprehura në rregulloren e brendshme të saj dhe ka ndërtuar rregulla për komunikimin dhe transparencën me klientët të cilat garantojnë standarde të larta për mirëmbajtjen e reputacionit të shoqërisë administruese.

Rreziku i Agjencisë

Rreziku i agjencisë ndodh kur administratorët e shoqërisë administruese apo dhe menaxherët e portofolit nuk marrin vendimi për rritjen e fitimit afatgjatë të shoqërisë administruese apo në shërbim të klientit por nisen nga synimet e tyre personale afatshkurtra.

Shoqëria Administruese ka ngritur rregullore të brendshme të cilat vendosin rregulla mbi sjelljet e menaxherëve të portofolit dhe administratorëve të shoqërisë administruese. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon procesin e investimeve dhe të transaksioneve të anëtarëve dhe është një element i rëndësishëm kontrolli.

Rreziku i ndryshimit të tatimit mbi pensionin vullnetar

Anëtarët siç pasqyrohet te seksioni VIII përfitojnë lehtësira tatimore nga anëtarësimi në Fond. Këto lehtësira tatimore aplikohet gjatë periudhës së kursimit, ndërkohë që në momentin tërheqjes së pensionit, ky pension tatohet me normën e tatimit që do jetë në fuqi në atë moment. Periudha afatgjatë (10-30) vjet mund të sjell ndryshime në normën tatimore që do aplikohet për pensionin që do tërheq anëtari.

Rreziku Ligjor

Rreziku ligjor shfaqet si pasoj e ndryshimeve në legjislacionin shqiptar në lidhje me fondet e pensionit vullnetar. Ndryshime të tilla mund të sjellin trajtime të ndryshme të skemës aktuale si në drejtimin e përfitimeve tatimore ashtu dhe ndryshime në moshën e përfitimit të pensionit.

Rreziku Politik

Kriza të theksuar politike mund të sjellin përkeqësim të aftësisë paguese të Shtetit Shqiptarë dhe për rrjedhojë uljen e vlerës së obligacioneve të tyre.

6. Para dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Llogari rrjedhëse në Banka Tirana	31.387,74	-
Depozita me afat maturimi deri në tre muaj	3.860.000,00	-
TOTALI	3.891.387,74	-

7. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme në Lekë janë detajuar si më poshtë:

	<u>30 shtator 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë	-	-
Të arkëtueshme nga shoqëria administruese	-	-
Të arkëtueshme nga depozitari	-	-
Parapagime	-	-
Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë	-	-
Të arkëtueshme të tjerë (nga interesi i depozitës)	296,11	-
Të arkëtueshme të tjerë (nga interesat e përlogaritura të obligacioneve qeveritare)	306.371,06	-
TOTALI	<u>306.667,17</u>	<u>-</u>

8. Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese paraqet vlerën e tarifës administrimi e përlogaritur në bazë ditore të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, përkatësisht, shpenzimi për muajin Prill-Qershor 2020.

	<u>30 shtator 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime nga investimi në letrat me vlerë	-	-
Detyrime nga investimi në depozita	-	-
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	65.026,61	-
Detyrime ndaj depozitarit	-	-
Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	-	-
Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë	-	-
Detyrime të tjera	-	-
TOTALI	<u>65.026,61</u>	<u>-</u>

Përgatiti:

Irfan LAMI

Drejtor i Departamentit të Financës Albsig Sh.a
(funksion i deleguar)

Miratoi:

Elton KORBI

Administrator i Përgjithshëm Albsig Invest Sh.a